



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr.1111/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbare të kreditorit “Haxhijaha Trade” sh.p.k., me seli në Rahovec, kundër debitorit Trepça sh.a, me seli në Mitrovicë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm – faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1400/22 të dt. 22.06.2023, me datën 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Trepça sh.a, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1400/22 të dt. 22.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1400/22 të dt. 22.06.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbaremit Trepça sh.a, me seli në Mitrovicë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremit P.nr.269/21 të datës 05.11.2021, të Përmbaremit Ilmi Miftaraj, me seli të zyrës në Mitrovicë, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit Trepça sh.a., me seli në Mitrovicë, dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1400/22 të dt. 22.06.2023.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremit si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Përmbaruesi Privat në cilësinë e organit përmbarues, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.269/21 të datës 05.11.2021, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.336/21 të datës 05.03.2021, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri ti paguaj kreditorit shumën prej 1,300.00 €, me kamatë vjetore prej 8 %, duke filluar prej datës 08.11.2021 e deri në ditën e pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrit të përmbaruesit privat mbi caktimin e përmbarimit, brenda afatit të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përmbarimit, duke theksuar se dokumentet në bazë të cilave është marrë vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk janë të përshtatshme për përmbarim, sepse në këto fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit ashtu siç parashihet në nenin 27 par.1 të LPP-së, në bazë të cilës thuhet se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. I ka propozuar gjykatës që ta anulojë urdhrin për përmbarim P.nr.269/2021 të datës 05.11.2021.

Kreditori i përmbarimit ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se debitori ka bërë prapësim duke i'u referuar afatit të pagesës, mirëpo i'u përgjigjemi me të gjitha dokumentet valide të nënshkruara dhe të vulosura nga debitori dhe nga kreditori të cilat e përcaktojnë afatin e pagesës siç janë Kontrata nr.024/2021, Numri i Kontratës 12997 12998-21-433-1-2-3/C280 në të cilën është cekur në nenin 4 par.4.4 ku thotë “Pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të kontratës”. Ndërsa në kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate në nenin 20 par.20.3 ceket “Shuma duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike”. Andaj, ka konsideruar se prapësimi është i pa bazuar dhe ka kërkuar që procedura përmbarimore të vazhdojë.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.1400/22 të dt. 22.06.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Trepça sh.a, me seli në Mitrovicë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.269/21 të datës 05.11.2021, të Përmbaruesit Ilmi Miftaraj, me seli të zyrës në Mitrovicë, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi, duke vendosur me decedivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e refuzuar në tërësi prapësimin e

debitorit dhe urdhrin përbarimor e ka lënë në fuqi. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përbarues ka caktuar përbarimin, i plotëson tiparet e përbarueshëmërisë.

Me Nenin 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP) është paraparë që për përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm *“është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”* Ndërsa me paragrafin 1 përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 37 të LPP-së përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* Prandaj, në këtë rast rezulton se dokumenti përkatësisht fatura Faturën Nr.336/21 të datës 05.03.2021 mbi bazën e të cilit është paraqitur propozimi për përbarim dhe është lejuar urdhrin, i plotëson kushtet sipas nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nga shkresat e lëndës është vërtetuar se propozimi për përbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhrin përbarimor, nuk përmban të meta ngase në propozimin është paraqitur dokumenti origjinal apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura, ashtu siç kërkohet edhe me nenin 38 par.1 të LPP-së, në të cilin parashihet se propozimi për përbarim, nder të tjerash duhet të përmbaje kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopja e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm. Andaj, në shkresat e lëndës rezulton se fatura me Nr.336/21 të datës 05.03.2021 është e vërtetuar, dhe më këtë raste paraqet dokument të besueshëm për përbarim sipas LPP-se

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në këtë çështjen konkrete juridike përbarimorë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur e ka refuzuar prapësimin me arsyet se urdhri për përbarim është lejuar mbi bazën e faturës, ku fatura përmban elementet thelbësore për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se fakti se fatura e lartcekur i përmban elementet për të qene dokumenti i besueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë i analizoi pretendimet e debitorit por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete ne mbështetje te tyre siç parashihet me nenin 69 par.4 te LPP, ashtu qe te njëjtat i refuzoi si te pabazuara.

Përndryshe në procedurën përbarimorë bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) tëLPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1111/23, me datë 08.03.2024

Gjyqtari
Dren Rogova